



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:008189

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05436591

P.nr.175/24

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Gani Kastrati, me procesmbajtësen Shureta Ballxhi, në çështjen penale ndaj akuzuarit: **A.N., nga Prizreni rr. "....." nr.**, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184.par.2.lidhur me par. 1. të KPRK-së nr. 06/L-074 sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr. 2237-4/23 të dt. 12.02.2024, me dt. 12.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim, e lidhur në mes të akuzuarit A.N., nga Prizreni rr. "....." nr. dhe të dëmtuarit E.Th., nga Prizreni rr. "....." lam....., në Qendrën e Ndërmjetësimit në Prizren QN. Ndm.83/24, e datës 05.03.2024.

II.HUDHET Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr. 2237-4/23 të dt. 12.02.2024 dhe

III.PUSHOHET procedura penale ndaj të akuzuarit **A.N.**, i ati e ëma e lindur, i lindur me dt. në Prizreni me vendbanim në rr. "....." nr., ka të kryer fakultetin, me profesion zyrtar doganor, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së mirë ekonomike, me numër personal, shqiptar shtetas i R. së Kosovës, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184.par.2.lidhur me par. 1. të KPRK-së nr. 06/L-074.

IV. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Ar sy e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren në këtë gjykatë ka parashtruar aktakuzë PP/II.nr. 2237-4/23 të dt. 12.02.2024, ndaj të pandehurit A.N., nga Prizreni rr. “.....” nr., për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184.par.2.lidhur me par. 1. të KPRK-së nr. 06/L-074.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me datë 01.03.2024 në të cilën kanë prezantuar Prokurori i shtetit Musli Gashi, i dëmtuari E.Th., nga Prizreni dhe i akuzuari A.N., nga Prizreni.

Me propozimin dhe pajtimin e palëve i akuzuari A.N., nga Prizreni dhe i dëmtuari E.Th., nga Prizreni të cilët i kanë propozuar gjykatës që këtë çështje ta dërgojë në procedurën e ndërmjetësimit dhe pas dhënies së mendimit dhe pajtimit nga prokurori i shtetit Musli Gashi, gjykata me aktvendim pranoj propozimin e palëve në bazë të ligjit për ndërmjetësim dhe KPPRK-së.

Me datë 01.03.2024, në Qendrën e Ndërmjetësimit në Prizren, është lidhur marrëveshja QN. NDM.nr. 175/24 për zgjidhjen e ndërmjetësuar ndërmjet të akuzuarit A.N., nga Prizreni rr. “.....” nr. dhe të dëmtuarit E.Th., nga Prizreni rr. “.....”.

Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të marrëveshjes për ndërmjetësim konstatoj se palët pa ndonjë kërcënim dhe me vetë dëshirë kanë shprehur gatishmërinë që kjo çështje të zgjidhet me ndërmjetësim dhe nuk kanë kontestuar asnjë nga pikat e marrëveshjes së ndërmjetësimit vendosi që ta aprovoj marrëveshjen si të bazuar.

Andaj, duke u bazuar në provat si më lart dhe në bazë të nenit 358, par. 1, nën par. 1.3, të KPPK dhe nenit 12, par.12.5, të Ligjit mbi ndërmjetësimin, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM ,
DIVIZIONI PENAL**

2024:008189, 12.03.2024

Gj y q t a r i

Gani Kastrati

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë.